



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:114687

Datë: 22.08.2023

Numri i dokumentit: 04607176

C.nr.1905/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.. K.. e Si. .., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i kompanisë “Debt Loan Recovery”, Sh.P.K. Besart Musa nga Prishtina, kundër të paditurit N.. .. B.. nga Gj.., . me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit 356.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor më datë 05.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses B.. K..e S.. .., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri N.. B.. nga Gj.., që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.02.2020, në Gjilan, t’ia paguaj paditësit shumën prej 356.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja B. K. e S., më datë 16.09.2020, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit N.. B. nga .. me objekt kontesti rimbursimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 356.00 euro.

Paditësi në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se me datë 12.02.2020, rreth orës 10:50 në Gjilan, ka ndodhur aksident në komunikacion, ku deri te aksidenti ka ardhur deri sa automjeti A-Motociklet të cilin e drejtonte i padituri N.. B., nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit Af.. H.. I njëjti ka theksuar se bazuar nga raporti i policisë vërtetohet se i padituri në momentin e aksidentit nuk ka pasur policë të sigurimit me çka paditëses i lindë e drejta për të kërkuar rimbursim të dëmit. Gjykatës i ka propozuar që në emër të rimbursimit, të detyrojë të paditurin që t’i paguaj paditësit shumën prej 364.00 euro me

kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në emër të taksës gjyqësore prej 20.00 euro.

I padituri N.B., në përgjigje në padi, në shqyrtimin gjyqësore dhe në shpjegimet përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton të tërësi padinë e paditësit, ku nga provat materiale e veçanërisht nga fotodokumentacioni i dëmeve të shkaktuara në veturë nuk shihet se cilat pjesë të veturës janë dëmtuar, e po ashtu në shkresat e lëndës nuk ka kupon fiskal i cili do ta vërtetonte shumën e paguar nga ana e paditësit në emër të rimbursimit por se në shkresat e lëndës ka vetëm një aktvlerësim të dëmit material e që kjo paraqet vetëm një ofertë të NTSH “Mercedes”, për rregullimin e veturës. I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar pasi që dëmi material nuk ka mundur të jetë në shumë prej 356.00 euro, për arsye se motoçikletën të cilën e ka vozitur nuk ka mundur të shkoj më shumë se 20 km , në orë pasi që e njëjta ka qenë e shkatërruar dhe e vjetër. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova; Ujdia jashtë-gjyqësore e datës 02.06.2020; Raporti policor; Transferi bankar; Procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 02.03.2020; Vlerësimin e dëmit të datës 06.03.2020; Fatura e servisit e datës 05.03.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses B.. K...e S...është e pabazuar.

-Nga ujdia jashtë-gjyqësore e datës 02.06.2020, gjykata vërtetoi faktin se B...K... e S... ka lidhë ujdi jashtë gjyqësore me A.. H..nga Gj., për pagesën në emër të zhdëmtimit në shumë prej 365.00 euro.

-Nga raporti policor, gjykata nukmundi të vërtetoj aksidentin e shkaktuar pasi që raporti policor ishte komplet i zbrazët.

-Nga transferi bankar, gjykata vërtetoi faktin se BKS përmes Bankës Ekonomike ka bërë transfer në N.T.Sh “Mercedes”, për Afrim Hajdarin në shumë prej 356.00 euro.

-Nga Procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 02.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se i dëmtuar ka qenë A.. H.. me llojin e veturës VW Golf 1K me targa 652-KS-157, viti i prodhimit 2003, nr sasisë WVW ZZZ1KZ4B005442.

-Nga vlerësimi i dëmit të datës 06.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se në veturën e pronarit A.. H., sipas vlerësimit dëmi është 356.95 euro.

-Nga fatura e servisit e datës 05.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se fatura për veturën Golf V me targa 652-KS-157, është në shumë prej 356.95 euro.

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në nenin 136, paragrafi 1 dhe 2 përcakton se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajit”; në nenin 137 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”; nenin 140 se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, nenin 154 se “Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”; nenin 155 se “Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”; nenin 159, paragrafi 1 se “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”; nenin 169, paragrafin 1 dhe 2 se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”; nenin 960, paragrafi 1 se “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”

Po ashtu gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të cilat përcaktojnë detyrimet e palëve në procedurë, edhe atë nenin 7, paragrafin 1 që përcakton se “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”; nenin 319, paragrafin 1 se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”; nenin 322, paragrafin 1, 2 dhe 3 se “Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuar, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Gjykata pasi vlerësoi dhe administroi faktet e paraqitura nga paditësja në këtë çështje kontestimore, gjeti se nuk është kontestuese se paditësja B.. K.. e .. i ka kompensuar dëmin e shkaktuar të dëmtuarit Af..H.., në llojin e veturës VW Golf 1K me targa ..., viti i prodhimit 2003, nr sasisë WVV ZZZ1KZ4B005442.

Mirëpo kontestuse ishte se a ishte shkaktar i aksidentit i padituri N.. B...nga Gj....

Nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, gjykata nuk arriti të vërtetoj se i padituri ka qenë shkaktar i aksidentit të ndodhur me datë 12.02.2020, rreth orës 10:50 në Gjilan, ku sipas paditëses deri te aksidenti ka ardhur deri sa automjeti A-Motociklet të cilin e drejtonte i padituri N. ... nga pakujdesia i shkaktonte dëme të dëmtuarit A... H..., pasi që gjykata i analizoi provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës gjeti se raporti i aksidentit është komplet i zbrazët pra nuk ka të shënuar në të asgjë dhe nga ky raport nuk mund të vërtetohet se i padituri ka qenë shkaktar i aksidentit e as nuk është prezentuar nga paditësja ndonjë vendim penal si aktakuzë apo aktgjykim apo i kundërvajtjes me të cilën do të vërtetohej një gjë e tillë.

Pra, gjykata vlerëson se është detyrë e paditësit të provojë faktet që i pretendon në kërkesëpadi, bazuar dispozitave të nenit 7, 319 dhe 322 të LPK-së, të theksuara si më sipër, që të vërtetojë bazën e kërkesës në këtë gjykatë, apo në të kundërtën gjykata vendos duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Kështu, gjykata ka gjetur se paditësi ka dështuar të vërtetojë se i padituri është shkaktar i aksidentit të datës 12.02.2020, pasi që e njejtë në fjalën përfundimtare e thekson se sipas raportit të policisë vërtetohet fajësia e të paditurit mirëpo kjo nuk u vërtetua sipas raportit të policisë të prezantuar nga paditësja e kjo vë në dyshim se si mund të theksohet një gjë kur në të nuk shënon asgjë pra është raport komplet i zbrazët.

Gjykata i analizoi edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës mirëpo këto prova nuk janë prova bindëse dhe vetëm me këto prova nuk mund të vërtetohet dyshimi i bazuar pa një raport policor apo një vendim penal siç është aktgjykimi apo kujdërvajtja.

Andaj gjykata nga këto fakte që i vërtetoi në këtë çështje kontestimore, gjeti se kërkesa e paditëses është e pabazuar, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në bazë të nenit 450 të LPK-së, meqë paditësja nuk pati sukses në procedurë, kurse i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat më lartë, bazuar në nenin 143, parag.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1905/2020, më datë 05.07.2023

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.